



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E APELIT TIRANË  
KRYETARI**

*Bulevardi "Zhan D'Ark" Tiranë, SHQIPËRI*      *Tel/Fax: 00 355 042 260284*

Nr. 62 Prot.

Tirane, me 15.04.2013

**V E N D I M**

Unë, Kryetari i Gjykatës së Apelit Tiranë, Alaudin MALAJ, në mbështetje të nenit 18 pika 1 dhe 3, shkronja "b" të ligjit nr.9877 date 18.02.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" dhe Rregulloren e Brëndshme "Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Gjyqësore", miratuar me Urdhërin e Ministrit të Drejtësisë nr.1830 datë 03.04.2001 dhe në mbështetje të ligjit nr.107/2012 "Për dhënie amnistie",

Ne vijim të vendimit nr.57 prot dt.21.11.2012 te Kryetarit te Gjykes, "Kur Gjykata e Apelit Tiranë vepron me procedurë të përshpejtuar"?

**V E N D O S A;**

Çështjet gjyqësore pranë Gjykatës së Apelit Tiranë shqyrtohen në bazë të një radhe gjykimi në përputhje me periudhën e regjistrimit pranë sekretarisë gjyqësore. Por, përjashtim nga ky rregull si pasojë e afateve të shkurtra për gjykim do të jenë dhe çështjet penale me objekt :

- 1- Ekstradime
- 2- Mase mjeksore
- 3- Sekuestro konservative

Per kete veprim ngarkohet Kryesekretarja dhe Kancelari.

**KRYETARI**

ALAUDIN MALAJ